



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË DOSJEVE

Korçë, më 22. 06. 2022
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

NJOFTIM

PËR KANDIDATËT QË KONKURROJNË PËR PORTALIN “MËSUES PËR SHQIPËRINË”, 2022 LIDHUR ME PROCESIN E ANKIMIT TË VLERËSIMIT TË DOSJEVE

Mbështetur në Udhëzimin Nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, si edhe shkresën e MAS “Për procedurat e konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022, njoftojmë kandidatët që kanë aplikuar përmes sistemit online në portalin “Mësues për Shqipërinë”, 2022 se vlerësimi i dosjeve të dërguara prej tyre ka përfunduar.

Të gjithë kandidatët mund të verifikojnë vlerësimin e tyre në hapësirën vetjake të portalit. Shpallja e listës së kandidatëve që kanë aplikuar në fazën e parë dhe u është pranuar dhe vlerësuar dosja do të bëhet në faqen elektronike të DRAP Korçë <http://korce.arsimiparauniversitar.gov.al/>, në datën **24.06.2022, ora 8,00**.

Pas publikimit të listës, çdo kandidat ka të drejtën e ankimimit për vlerësimin e dosjes si edhe të të dhënave të tij të pasqyruara në listë.

Afati i ankimimit është prej datës 24.06.2022 deri në datën 27.06.2022.

Për këtë, duhet të drejtohet pranë ZVAP (zyrës vendore të arsimit parauniversitar) në të cilën ka vendbanimin ku dë të drejtojë ankesën e vet.

Në çdo ZVAP do të ngarkohet një person përgjegjës i cili do të mbledhë ankesat dhe do i dërgojë përmes postës elektronike në DRAP Korçë.

Asnjë ankesë e cila mund të drejtohet në forma të tjera nuk do të merret parasysh.

Sqarim!

Kandidatëve të cilët kanë zgjedhur të mbajnë pikët e dosjes, u është shqyrtuar dokumentacioni përkatës në dosje, por nuk u është kryer rivlerësim i saj.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!



Adresa: “ Dhimitër Denasi”
Lgj. 18, AL 7001, Korçë
website: <http://korce.arsimiparauniversitar.gov.al/>